

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27-28 KORRIK 2023

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Refik Maloku, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Adnan Lahu, Fatmire Cecelia, dhe Nurie Halili.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –duke ju referuar një postimi në rrejtët sociale të një qytetari për siç deklaroi se i njëjti shpreh pakënaqësi dhe pretendon se komuna ka mashtruar, lidhur me projektin me OJQ-në Islamic Relief për pajisjen dhe montimi me sera për prodhime bujqësore. Ky qytetar deklaroi se ky projekt është dashur të përfundoj më së largu në fund të muajit prill 2023, por ky projekt edhe pse jemi në fund të muajit korrik i njëjti akoma është larg përfundimi ndonëse qytetaret i kanë kryer obligimet e participimit, ndërsa komuna pretendon se ky projekt është dyvjeçar. Andaj pyetja e tij është për drejtorin e bujqësisë se çka po ndodh në të vërtetë? A keni evidencë të saktë se sa sera janë dorëzuar tek përfituesit? A janë montuar të gjitha sipas kontratës dhe afateve kontraktuese? Përfituesi të cilët janë shpallur a janë real apo janë stërshitur këto sera, a ka evidencë të saktë për këto sepse komuna ka obligim të ketë regjistër të saktë mbi donacionet. Ky projekt dihet se është me bashkëfinancim me OJQ-në Islamic Relief, por komuna mbanë përgjegjësinë për shpërndarjen reale dhe regjistrin e saktë që duhet të mbajë. Një tjetër problem që ai e potencoi është ai mushkonjave, dhe komuna është dashur të kontaktoj kompani profesionale për dezinfektim dhe kjo është e paraparë të ndodh gjatë muajit qershor, por kjo nuk

ka ndodhur, kjo konkretisht është e detyrë e përshkruar tek Drejtoria e Shëndetësisë. Andaj kërkoj që kjo çështje të proritizohet dhe të iniciohet aktiviteti i prokurimit për lidhjen e kontratës për dezinfektimin sa më të shpejt të qytetit për shkak se kjo është çështje e nevojës imediate.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-adresoje kritika për siç tha që i ka pranuar nga qytetarët për dëmtimin e sheshit "Adem Jashari" ku janë thyer pllakat janë dëmtuar pusetat dhe kanale e në ç' rast po rrezikohen qytetarët për lëndim gjatë kalimit nëpër këtë shesh. Andaj çfarë është duke ndërmarr qeveria komunale për rregullimin e këtij sheshi. Ndër kritikën tjerë është edhe sa i përket N.P.L Përparimit, kamionët e kësaj ndërmarrje batin lloqin në rrugët kryesore. Pastaj pyeti kryeartin e komunës se premtimi i tij elektorale për kabinetin qeveritar që do të jetë gjysma e tij e përbërë nga grat, a ka qenë vetëm për vitin e parë qeverisë sepse pas shkarkimit të dy drejtoreshave komunale ato janë zëvendësuar me burra dhe nuk ka pasur përmbushje të premtimit në këtë drejtim. Po ashtu kemi edhe ikje tjerë të grave profesionistët të administratës komunale e rasti më i freskët është ai i znj. Merita Mulaku, e cila me gjithë përvojën e saj është dorëhequr nga administrata për shkak se nuk ka gjetur përkrahjen e kryetarit të komunës për akomodim në ndonjë pozitë profesionale në administratën e komunës. Në fund pyeti drejtoreshën e kulturës se deri ku ka shkuar procesi i subvencionimit të klubeve sportive, sepse ato po kanë ankesa në zhvillimin e aktiviteteve të tyre.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-ngrid problemin e mos zbatimit të Rregullores Komonale për Dekorata nga ana e DKRS-së në Vushtrri, për faktin se sportisti ynë z.Rilind Musa i cili në vitin 2020 ka fituar vendin e dytë në kampionatin botëror në sportin bodybording të mbajtur në Santa Sazana në Spanjë, po ashtu i njëjti sportist ka arritur edhe rezultatet kulminante në kontekst mbarëkombëtar. Në këtë relacion neni 9 i Rregullores për Dekorata përcakton citojmë:

1. Çmimi "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" iu ndahet sportistëve individual (një sportisti) dhe sportit kolektiv (një klubi sportiv) për arritje kulminante në sport në gara me karakter nacional apo ndërkombëtar.

2. Çmimin "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" e ndan kryetari i komunës në mënyrë solemne;

3. Për arritje në sportin individual, sportistit/es së bashku me dekoratën, i ndahet edhe shpërblimi në shumë prej dymijë euro (2,000.00 €) ndërsa për sportin kolektiv-klubit i ndahet shpërblim në shumë prej pesëmijë euro (5,000.00 €).

4. Medalja ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz e pruar në ngjyrë ari, me diametër 7 cm, në mesin e së cilës gjendet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, si dhe Mbishkrimi "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" ndërkaq nën të shkruhet emri dhe mbiemri i të dekoruarit;

5. Fletëpërcjellja përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë të formatit A4 dhe në sfondin e fletës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë". Pyetja e tij ishte për drejtoreshën e kulturës se përse nuk është zbatuar kjo rregullore dhe propozoi që sportistit Rilind Musa të ndahet çmimi "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë". Po ashtu pyeti drejtoreshën e administratës se përse nuk po bëhet pagesa e kryetarëve të këshillave të fshatrave, pasi që kjo çështje është e rregulluar me udhëzim administrativë dhe me ligjet në fuqi, pyeti se kur do të filloj pagesa e këtyre këshillave.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-shprehu keqardhjen e saj se si Drejtoresha e Kulturës nuk e kishte marrë mund që as një emil të dërguar nga sportisti Rilind Musa të ia kthej, për me keq nga kjo e fundit ishte manipulua për gjoja se biseda me zyrtarin ligjor kishte qenë që kjo çështje e propozimit për këtë çmim është në dorën e kuvendit. Edhe pse dihet se propozimi shkon nga ana e komisionit që formohet nga Drejtoria e Kulturës respektivisht Kryetari i Komunës. Ajo kërkoj

që mos të bëhen këso lloj injorimesh dhe manipulimesh me sportistët tanë që kanë kaluar një rrugë jo të lehtë për të arritur suksese në arenën ndërkombëtare. Propozoi që z.Arlind Musa t'i ndahet çmimi "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë". Në fund deklaroi se vendim për mbylljen e qendrave të mjekësisë familjare gjatë vikendeve është skandaloz dhe kërkoj që ai të shfuqizohet sa më parë.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-shprehu pakënaqësinë e tij dhe adresoj ankesat dhe indinjatën e banorëve të fshatrave të rajonit të Rrekës së Kuqe, për mungesën e ujit të pijes projekt i cili ka mbetur në gjysmë nga mandati i kaluar dhe atë për vetëm vendosjen e pompave sepse punët tjera janë përfunduar, kjo është neglizhencë papërgjegjësi dhe mos punë e qeverisë aktuale komunale.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-adresoj një ankesë dhe problematikë të një banori të fshatit Samdrexhë z.Ismet Maloku, problem i cili ka të bëjë me derdhjen e ujit në oborrin e shtëpisë së tij e që për pasoj uji po e godet murin e shtëpisë dhe kesisoj e tërë shtëpia është mykur dhe kështu kjo familje ka edhe problem shëndetësore. Kjo ka ardhur si rezultat i mbylljes së kanalit gjatë shtrimit të trotuarit i cili është bërë në mënyrë jo profesionale. Andaj kërkon që në mënyrë urgjente të intervenohet në zgjidhjen e këtij problemi sepse ky qytetar tashmë i ka shterur të gjitha mjetet ankimore.

Edona Gashi, anëtare e kuvendit-tha se është duke e pritur një raport nga kryetari i komunës të cilën e kishte kërkuar më herët, për pagesën e avokatit të komunës që është kontraktuar nga kryetari i komunës në vlerë prej 18,000.00 €, për shërbime juridike, dhe për lëndët që janë kthyer në favor të komunës, cilat janë ato lëndë që i ka fituar komuna, dhe për këtë akoma nuk ka marr asnjë përgjigje, edhe pse kërkesën e ka parashtruar në dhjetor të vitit 2022.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës-tha se të gjitha temat dhe informata që kërkohen nga anëtarët e kuvendit, mundohet ti arsyetoj edhe atëherë kur ato nuk kanë arsye, dhe shtoj se për këto tema do të përgjigjen drejtorët e drejtorive komunale që janë kompetent për ato tema. Pastaj vlerësoi se për çështjen e QKMF-së e shih të arsyeshme të ngritet një komision për verifikimin e gjendje në atë objekt, por për këtë arsye për shqetësim do të kenë ata që kanë qenë më herët në pushtë në kohen e të cilëve është ndërtuar ky objekt. Ky komision për konstatimin e gjendjes faktike në objektin e QKMF-së le të ngritet dhe le të bëhet publike sepse ka pasur devijim të tmerrshëm të projektit të ndërtimit të këtij objekt, komision le të vjen me një raport dhe ai raport më pas le të dërgohet në prokurorinë e shtetit për hetim zyrtarë. Ndërtimi i këtij objekti ka filluar fillimisht pa projekt kur drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë ka qenë Sylejman Mehulli, ndërsa më vonë askund nuk përputhet projekti me gjendjen në teren dhe kjo është tepër shqetësuese, kjo edhe për faktin se shkallët e këtij objekti janë jashtëzakonisht të ngushta, ku një nga doktorët e kësaj qendre alarmon se nëse vdes ndonjë pacient nuk mund të nxirret jashtë objektit për shkak se krevatin e qendrës nuk e zënë shkallë e objekti që janë jashtë çdo standardi të ndërtuara për shkak të ngushtësisë. Lidhur me dëmtimin e pllakave në shesh tha se është shumë i shqetësuar dhe apeloj tek anëtarja e kuvendit znj.Gërguri që të jetë më liberale dhe jo e ngarkuar politikisht, sepse ai nuk e ka këtë kompleksë. Për sheshin ka filluar hartimi i projektit, dhe vlerësoi se nuk kishte pasur dëshirë të merret me këtë projekt, sepse për kohën kur ishte ndërtuar ky shesh ka qenë një ndër sheshet më të bukëra në Kosovë. Ai i kishte thënë ish kryetari të Komunës Bajram Mulaku se kishte bërë një shesh mjaft të bukur, por nuk ia kishte pranuar që ai nuk kishte reaguar kur ish kryetari i komunës Xhafer Tahiri, i kishte dërguar ekskavatorëve për thyerjen e betoneve dhe prerjen e drunjtëve, e në ç' rast i kishte dëmtuar dhe thyer pllakat e sheshit sepse ato pllaka nuk kanë qenë të parapara të futen pesha të rënda siç është ekskavatori. Lidhur me N.P.L "Përparimi" vlerësoi se është bërë shumë mirë që është ndërtuar kjo ndërmarrje, por ceku se ata punëtor më herët janë paguar direkt nga buxheti i komunës, ndërsa tani komuna e dhënë punë kësaj ndërmarrje duke rregulluar ndriçimin publik dhe si rezultat i suksesit në menaxhimin e kësaj ndërmarrje janë rritur pagat e

tyre për 20%. Lidhur me rregulloren për dekorata dhe ndarjen e çmimeve ceku se këtë të drejtë për propozime për dekorata e kanë edhe anëtarët e kuvendit. Mandej njoftoi se pompat për ujësjellës janë montuar është marrë licenca për kyçje në rrjetin elektrik, tani mendohet të bëhet testimi i gypave dhe shumë shpejt do të lëshohet uji i pijes nga ujësjellësi. Në fund lidhur me angazhimin e avokatit nga komuna, njoftoi se ai është kontraktuar përmes procedurave tenderues nga Drejtoria e Prokurimit i njëjti ka fituar disa lëndë, disa janë në procedurë dhe për të gjitha këto mund të ketë qasje kushdo që ka interes për këtë çështje.

Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS-së-pasi i përshëndeti të pranishmit tha se Nën ombrellën e QKMF janë QMF dhe AMF, të cilat janë në shërbim të qytetarëve dhe për qytetarin. Kujdesi Parësor Shëndetësor nuk ka obligim ligjor dhënien e infuzioneve. Lidhur me pretendimet të cilat tentojnë ta dëmtojnë rëndë punën tonë dhe punën e stafit profesional mjekësor në Komunën e Vushtrrisë, ju informoj se ne jemi ata të cilët pranojmë kritika, por kritika duhet të ketë bazën e mirëfilltë dhe të jetë me vend, por jo sulme politike. QKMF ka ndërruar lokacionin dhe për shkak të mungesës së sektorit të kujdesit urgjent ditëve të vikendit nuk do të punohet, mbi bazën e mungesës së sektorit të kujdesit urgjent, në rast të shfaqjes së alergjive gjatë marrjes së terapive tek pacientët. QMF-1 do të ofrojë shërbime për të gjithë qytetarët pa dallim 24/7, kemi angazhuar staf shtesë ku do ofrohen shërbime mjekësore duke përfshirë edhe sektorin e kujdesit urgjent, që të ju jemi afër të gjithë qytetarëve dhe mërgimtarëve tanë. Për informim publik në vitin 2018 gjatë qeverisjes së LVV është bërë vlerësimi i shërbimeve shëndetësore nga AQH dhe ju e dini mirë se jeni renditur të tretët nga fundi për cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Këtë vit është bërë rivlerësimi për cilësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ku do ju njoftojmë për progresin. Qytetarë të nderuar, ne jemi këtu për ju dhe në shërbimin tuaj, çdo pakënaqësi ju lutemi adresojeni në vendin e ankesave. Lidhur me pretendimet e anëtarit të kuvendit Sylejman Meholli, ai deklaroi se në kohën sa ai ishte në pozitën e drejtorit të shëndetësi është ngritur –ndërtuar objekti i ri QKMF-së dhe në këtë ka pasur devijim të projekti ashtu që ky objekt është ndërtuar jashtë çdo standardi ndërtimor, shkallët janë ngushta tej mase dhe kësaj ky objekt i mungon ajrosja. Lidhur me këto shkelej që kanë ndodhur në kohën e Sylejman Mehollit, kërkoj të ngritet një komision për konstatimin e gjendje faktike në atë objekt dhe të dilet me një raport i cili duhet të dërgohet në prokurorinë e shteti për hetimin e kësaj çështje.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-sqaroi se projekti i ndërtimi të QKMF-së është hartuar nga Drejtoria e Urbanizimit, dhe kjo gjë është publike, pastaj Këshilli Drejtues i QKMF-së e ka miratuar këtë projekt, ky projekt ka qenë tre vjeçar ndërsa ai i drejtor i shëndetësisë e kishte lënë mandatin me 29 janar 2021, dhe më pas është vazhduar ky projekt nga të tjerët, dhe nga qeveria aktuale e komunës është bërë pranimit teknik i këtij objekti, menaxher i projektit kanë qenë zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizimit. Ai shtoi se ndoshta në këtë projekt ka mundur të ketë devijime, por përgjegjësia bie mbi ata të cilët kanë lejuar zhvillimin e këtij projekti dhe pranimin teknik të tij. Mandej shtoi se udhëheqësia komunale e shëndetësisë është aq e dobët dhe naive sa që nuk ka mbetur kush pa qeshur me arsyetimin që është dhënë për mbylljen e qendrave të mjekësisë familjare. Arsyetimet që janë dhënë janë të nduarduarshme dhe janë qesharake, sepse njëherë thuhet se mbyllja ka ndodhur si rezultat i mungesës së urgjencës, mandej thuhet rreziku për alergji, dhe këtë arsyetim janë qesharake dhe skandaloze. Mandej shtoi dhe deklaroi se kur e kishte marrë ai drejtimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, gjendje nëpër qendrat e mjekësisë familjare është karakterizuar me mijë-papastërti të tmerrshme dhe me shumë mangësi tjera, një pjesë të përgjegjësisë në këtë drejtim e bartë edhe vëllai i kryetari aktual të komunës i ndjeri Dr. Safet Idrizi. Në këtë rrafsh ceku se si drejtues i shëndetësisë komunale e kishte transformuar sistemin e funksionimit të sistemit të mjekësisë familjare dhe ishte ngritur kualitetit i shërbimeve shëndetësore. Në fund tha se kryetari i komunës duhet të dalë dhe të kërkojë falje për degradimin e shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë, sepse kemi rreth 70,000 € shërbime laboratorike më pak

se sa viteve të kaluar dhe kjo e dëmton direkt gjepin e qytetari sepse ata analizat duhet ti bëjnë privat.

Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS-së-vlerësoi se anëtarin e kuvendit z.Sylejman Mehollin asnjëherë nuk e ka pa kaq të shqetësuar, madje ceku se ky njëri është një demagog dhe retorika e tij për numrin e analizave në laborator është propagandë sepse gjatë pandemisë normal ka pas më shumë analiza për shkak të shqetësimeve që kanë mbretëruar.

Bujar Pllana, anëtar i kuvendit –tha se arsyetimi që është bërë për mbylljen e qendrës së mjekësisë familjare është i paqëndrueshëm, sepse mund të ketë arsye tjera por jo ato që lidhen me alergjitë apo urgjencën sepse këto janë të paqëndrueshme.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit –tha se pa dashur me të merret me arsyetimet e drejtorit të shëndetësisë, ceku se nuk është bërë mbyllja e qendrës familjare, por është shtuar numri i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, kjo për faktin se aktualisht në QKMF-në e Vushtrisë nuk punohet 12 orë por 16 orë, prej orës 20:00 deri në ora 23:00 kemi mjek shtesë. Sa i përket pezullimit të punës gjatë ditëve të vikendeve në QKMF, a ka qenë i pajtimit që të funksionoj vetëm Qendra e Mjekësisë Familjare 1 sepse kjo i plotëson të gjitha kushtet, kësaj nuk ka asnjë ankesë nga qytetarët sepse askush nuk është refuzuar që ti ofrohet shërbim shëndetësor dhe pritja maksimale në radhë e pacientëve është maksimum 5 minuta. Në fund ai tha se nuk k nevojë të shqetësohen qytetarët sepse shërbimet janë duke u ofruar me rregull, dhe apeloj që mos të kemi intreferrime në shëndetësi nga askush nga politika.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se Qendra e Mjekësisë Familjare 1 nuk i ka kapacitetet e duhura dhe të nevojshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore sepse e njëjta ka në dispozicion vetëm katër shtretër. Në këtë kontekst duhet të gjendet edhe ndonjë zgjidhje alternative me organizime fushore apo ambulanca mobile sidomos gjatë ditëve të nxehta të verës kur janë prezent bashkatdhetarët tanë. Ai kërkoj që të thirret arsyeja nga të gjithë për gjetjen e një zgjidhje oportun për mos ta mbyllur qendrën e mjekësisë por të bëhet rritja dhe kualiteti i shërbimeve shëndetësore për qytetarët tanë.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se disa drejtor të drejtorive po harrojnë që kuvendi i komunës është organi më i lartë i komunës, dhe duke ju referuar Drejtoreshës së Kulturës, e cila nuk i jep përgjigjet në pyetjet e parashtruara kjo tregon për mos përfillje të anëtarëve të kuvendit, në këtë kontekst i gjithë debati zhvillohet mes Sylejman Mehollit dhe Nexhmendin Rashicës dhe kjo dihet se ata kanë problem personal. Pastaj shtoi se duhet të ngritet niveli i shërbimeve shëndetësore, sepse ky nivel ka rënë nga koha kur ka qeverisur LVV-ja me shëndetësinë komunale.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –lidhur me ndërtimin e objektit të QKMF-së, vlerësoi se ka shumë lëshime në këtë projekt, ku përveç shkallëve të ngushta, mungesës së hapësirës dritareve dhe ajrosjes, por nuk u përmend bodrumi i cili nuk ka dranazhim dhe izolim ku për pasojë kemi mbushje të podrumit me ujë sa herë që bie shi, dhe kësaj uji e ka djegur tërë aparaturën e nxehjes qendrore. Ajo çka është më se problematike është se ka dyer me dimensione 70 cm, dhe për këtë vjen dikush këtu dhe deklaron se iu mbaj ligjërata. Ky projekt objekti i ri i QKMF-së i ndërtuar për së mbrapshti është dhuratë e ish-kryetarit Xhafer Tahiri dhe ish-drejtorit Sylejman Mehollit, këta nuk kanë të drejtë të na mbajnë ligjërata. Ajo çka është esenciale është se vlera bazë e kontratës për këtë objekt ka qenë 346,222 €, ndërsa në nenin 2 të kontratës thuhet çmimi bazë i cekur në kontratë duhet të jetë e vetmja pagesë që autoriteti kontraktues i ka borxh kontraktuesit sipas kontratës, ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve. Dhe në këtë kontekst çfarë ka ndodhur për këtë projekt ndërtimi i objektit të QKMF-së në saje të një aneks kontrate janë paguar edhe 34,622 € gjë e cila ka të bëjë me shkeljen e kontratës bazë, dhe për të qenë akoma më keq për një ditë është përfunduar aneks kontrata. Andaj ai propozoi që konfrom rregullores të

procedohet formimi i një komisioni profesionalë që do të merrej me verifikimin e këtij procesi-ndërtimi i objekt të ri të QKMF-së dhe me tej lënda të procedohet për hetim tek organet e drejtësisë. **Ferit Idrizi, Kryetar i komunës**-tha se nuk është mirë të flitet e të përflitet për njerëz-intelektual të cilët kanë ikur nga kjo botë, dhe për këtë fjalën e kishte për intelektualin doktorin tashmë të ndjerë Dr.Safet Idrizi, i cili ka lënë një trashëgimi dhe gjurmë të pashlyeshme në historianë e shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë dhe jo vetëm. Sa i përket ujit të pijes tha se kushdo që ka bërë punë të mira është për tu përshëndetur sepse ka bërë punë në interes qytetar e për këtë ai nuk ka ngarkesa politike për t'ia pranuar dhe njohur meritat. Për sistemin e pompimit të ujit të pijes tha se janë fazën e projektimit, edhe pse më herët ishte lidhur një kontratë për projekte vlera e të cilës ishte 250,000 € ndërsa nuk ishte bërë asnjë projekt. Më tej shtoj dhe përsërit se objekti i QKMF-së është ndërtuar në kundërshtim me çdo standard ndërtimor, në kohën kur drejtor i Shëndetësisë ka qenë Sylejman Mehulli, dhe për këtë dhe objekte tjera kërkoj me ngulëm të themelohet komisioni i cili do të merret me verifikimin dhe konstatimin e gjendjes faktike për objektin e QKMF-së.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me ngarkesat politike të kryetarit të komunës i cili pretendon se është kryetar i të gjithëve, shtoj se emrin e QKMF-së pllakën dhe mbishkrimin me emrin e Dr.Safet Idrizit, kryetari e ka vendosur menjëherë sepse është vëllai i tij, ndërsa për emërtimin e Teatrit të Qytetit me emrin "Adem Mikullovcit" kryetari ka hezituuar ta vendos dhe këtë e ka bërë iniciativa e LVV-së në Vushtri, andaj kjo tregon më së mirë për paanësinë dhe ngarkesën politike të kryetarit aktual të komunës i cili nuk është ai i cili hiqet së është i tillë, ndërsa ai ka krejt tjetër qasje dhe vepron me një demagogji politike. Lidhur me standardet e ndërtimit të objekteve shëndetësore do të bëhet verifikimi i të gjitha objekteve, ku është punuar jashtë çdo standardi, dhe imagjinon është bërë ndërtimi i laboratorit të QMF-1 përmbi gypat e hidrantit Ibër Lepencit dhe si ka logjikë të ndërtohet mbi gypat super-barik të Ibër Lepencit dhe ky është projekt i PDK-së. Nëse flasim për standardet mjekësore inspektorati e ka dënua Komunën e Vushtrrisë me 1000 € për shkelej dhe ky vendim është publik. Në fund tha dhe kërkoj të ngritet komisioni për verifikimin e të gjitha objekteve shëndetësore duke i konstatuar standardet e ndërtimit të tyre dhe më pas kërkon të ketë një ballafaqim medial me kryetarin e komunës.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-duke ju referuar diskutimeve të kryetarit të komunës, ceku se sa herë që kryetari të komunës i mungon forca e argumenteve kthehet në demagogji politike duke i fyer anëtarët e kuvendit. Nëse argument për kryetarin e komunës është qeverisja e kaluar atëherë për çfarë është ky kryetar dhe kjo qeveri që për një vit e gjysmë asgjë nuk ka bërë po thotë ndërtimi i sheshit, por Komuna e Vushtrrisë nuk e ka komoditetin të ndërroj dhe ndërtoj sheshet e njëjta për çdo mandatë.

Ergin Sunguri, drejtor i DEBPZHR-së-paraqiti sqarime lidhur procesin e shpërndarjes së serave në bujqësi, ku tregoj se ky proces është projekt dyvjeçar, ndërsa është në zhvillim e sipër si projekt mes komunës dhe Islamic Reliefit. Procesi i shpërndarjes dhe përzgjedhjes së këtyre serave ka qenë plotësisht transparent, dhe është në përfundim e sipër.

Hava Rruka-Mlinaku, paraqiti sqarime për sa i përket pagesë së këshillave të fshatrave, ku njoftoi se Ligji i ri i Pagave ka sjellë mjaft shumë telashe sepse mundëson vetëm pagesën e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-propozoi që pika 3 dhe 4 e rendit të ditës të fuzionohet në një pikë të vetëm, dhe këtë e argumentoj me faktin se këto rregullore janë të natyrës së njëjtë dhe rregullojnë çështje që janë të përbashkëta. Tutje shtoi se komisioni për hartimin e rregullores për Komitetet dhe Komisionet e Kuvendit ka qenë një vizitë jashtë vendit për hartimin e kësaj rregulloreje dhe nuk e ka kryer punën e tij duke e shtyrë hartimin deri në 7 muaj. Për më tepër këtë rregullore e ka shpallë si të kundërligjshme MAPL-ja, problemi tjetër është se në bazë të Ministrisë

së Financave, paguhen vetëm dy komitetit për komunitete dhe KPF-ja, andaj do të dalin problemet e pamundësisë së pagesës për këtë komisionet tjera. Propozoi që të hartohet një rregullore me titull Rregullorja e Punës së Kuvendi dhe Komiteteve.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kryesuesja e kuvendit duhet të jep verdiktin e saj për materialet që procedohen në kuvend sepse nuk ka ndodhur më herët në praktikë që kuvendi të aprovoj materiale të korrigjuara nga komisionet për çështje të caktuara. Pastaj propozoi që pika e 3 rendit të ditës Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Punën e Kuvendit, të hiqet nga rendi i ditës, për arsye se kjo draft-rregullore është punuar në kundërshtim të plotë me vendimin për themelimin e komisionit hartues, sepse komisioni ka pasur për detyrë vetë të bëj plotësim-ndryshimin e rregullores së kuvend e jo të hartoj rregullore të re. Nëse kjo rregullore procedohet në rendin e ditës dhe aprovohet ai do apeloj në MAPL. Më tej konstatoi dhe njoftoi se nga 14 pretendime të apeluara nga anëtarë të kuvendit 13 kanë qenë të pabazuar ndërsa MAPL lidhur me rregulloren e për komisionet ka kërkuar vetëm të përmirësohet neni 4.4 dhe e njëjta të hynë në fuqi.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-propozoi që pika e 4 e rendit të ditës Rishqyrtimi i Rregullores për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit, të hiqet nga rendi i ditës për faktin se nëse themelohen këto komitetet dhe komisione do të shfaqet pengesa e pagesës së tyre. Nëse ministria kompetente lejon pagesën e këtyre komisioneve atëherë le procedohet aprovimi i kësaj rregulloreje.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –tha se qysh në fillim kishte paralajmëruar se Rregullorja për Komitetet ishte hartuar në kundërshtim me ligjin, dhe ashtu edhe ndodhi. Pastaj shtoi se në vendimin për themelimin e komisionit për rregulloren e punës së kuvendit, ceket se komisioni ka për detyrë të bëj plotësim ndryshimin (hartimin) e Rregullores të punës së Kuvendit, dhe komisioni në fjalë e ka kryer punën e tij në mënyrën më të mirë të mundshme dhe brenda suazave të ligjit. Propozoi dhe kërkoi që pika e 4 Rishqyrtimi i Rregullores për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të hiqet nga rendi i ditës.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-propozoi që të futet në rend të ditës propozim për ndarjen e çmimit “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” për sportisten z.Rilind Musa.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me propozimin për themelimin e Komisionit për verifikimin dhe konstatimin e gjendjes në objektin e ri të QKMF-së, propozoi që objektivi e punës e këtij komisioni duhet të jetë komplet rrjeti i objekteve të kujdesit parësor shëndetësor, duke u futur edhe monitorimi i standardeve të cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe standardi i objekteve tjera.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se nuk ishte fjala tek vlerësimi i standardeve të shërbimeve shëndetësore sepse ato vlerësohen nga instancat tjera. Por në rastin konkret në ndërtimin e objektit të ri të QKMF-së kanë ndodhur dy shkelej esenciale e para lidhet me fillimin e ndërtimit të këtij objekti pa pasur projekt, ndërsa tjetra është shpallja e procedurave të prokurimit dhe më pas hartimi i projektit, e që nuk kanë pasur të drejtë. Andaj objektivi i komisionit të jetë verifikim se a janë ndërtuar të gjitha QKMF-të, QMF-të dhe AMF-të, sipas paramasave dhe parallogarive dhe sipas projektit, gjithashtu pjesë e verifikimit duhet të jetë edhe renovimet e këtyre objekteve që kanë ndodhur në të gjitha periudhat a janë bërë sipas paramasave dhe parallogarive, sepse ka informacione se në kohën kur drejtor i Shëndetësisë ka qenë Sylejman Mehulli, ka pasur ndryshim të madhe të sistemit të kaldajave në disa QMF.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-vlerësoi se propozim për ngritjen e një komisioni të tillë për verifikim të ndërtimeve të objekteve shëndetësore vërtet është absurd, sepse anëtarët e kuvendit nuk kanë për obligim të marrin metrin dhe të matin objekte se si janë ndërtuar ato. Për këtë çështje janë edhe organet gjegjëse kompetente, andaj ai e kundërshtoi formimin e këtij komisioni.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-pyeti drejtorin e Financave se nëse aprovohet Rregullorja për Komitetet, atëherë kah do t'i merr mjetet financiare për pagesën e këtyre komiteteve.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se me hyrjen në fuqi të ligjit të pagave, të gjitha ligjet dhe udhëzimet që rregullojnë fushën e kompensimit janë shfuqizuar. Andaj pagesa bëhet vetëm për dy komitetet obligative dhe kësaj po hasim në pengesa në realizimin e këtyre vendimeve. Në këtë kontekst aprovimi i kësaj rregulloreje nuk mundëson edhe pagesën e këtyre komiteteve.

Në vazhdim kuvendi pas votimit me 27 vota "për" 1 votë "kundër" vendosi që të mbetet në rendin e ditës Draft – Rregullorja për Punën e Kuvendit.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota "për" aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29-30 qershor 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 7 korrik 2023;
3. Shqyrtimi i Draft – Rregullore për Punën e Kuvendit;
4. Rishqyrtimi i Rregullore për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit;
5. Shqyrtimi i Draft – Rregullore për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale;
6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor Financiar, Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore; Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve;
8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës janar – qershor 2023;
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
10. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022/2023;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft - Rregullore për Kategorizimin e Klubeve Sportive në Komunën e Vushtrrisë;
12. Shqyrtimi i kërkesës së Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës – ish-objekti i QKMF-së për nevojat e Spitalit në Vushtri;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për themelimin e KKSB-së;
14. Shqyrtimi Informatës gjashtë mujore lidhur me punën e KKSB-së;
15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për verifikimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së në Vushtri dhe objektet tjera shëndetësore;
16. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarjen e çmimit "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" për z.Rilind Musa;
17. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29-30 qershor 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29-30 qershor 2023.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 7 korrik 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 22 vota “për”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 7 korrik 2023.

3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Punën e Kuvendit;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-paraqiti vërejtjet e tij tek neni 22 i kësaj draft-rregulloreje shkarkimi i kryesuesit të kuvendit, ku në saje të një interpretim nga MAPL-ja, që anëtarët e kuvendit të komunës kanë të drejtë të propozojnë me shumicën e thjesht të votave të propozojnë çfarëdo pike të rendit të ditës përfshirë edhe kërkesën për shkarkim të kryesuesit të kuvendit me mundësi që gjatë seancës të procedohet kërkesa. Andaj kërkoj që kjo dispozitë të hiqet nga rregullorja pasi që bie ndesh me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe interpretimet e MAPL-së lidhur me këtë çështje. Nëse kjo nuk hiqet ata do ta apelojnë këtë rregullore dhe do të kthehet si e kundërligjshme.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kjo rregullore për pos që është në kundërshtim me vendimin për formimin e komisionit nga i cili burojnë autorizimet e tij, ajo ka një bazë juridike ju të qëndrueshme sepse që në preambulë thirret në nenet jo përkatëse të ligjit. Ky dokument nuk i përmbushë kushte dhe pritshmëritë për një rregullore të zbatueshme e cila do ta lehtësonte punën e kuvendit. Mandej thirrja juridike është gabim edhe për sa i përket statutit të komunës, thirrja në statut duhet të jetë neni 17 pika 4 e tij. Pastaj siç shihet në saj të procesverbalit të komisioni ceket se puna e komisionit është plotësim-ndryshimi i rregullores së kuvendit, ndërsa veprohet edhe kundër këtij procesverbal duke hartuar një rregullore të re, andaj kësaj veprohet kundër mandatit dhe autorizimeve që i kanë marrë nga kuvendi. Nga të cekurat më lartë rezulton se komisioni nuk e ka kryer si duhet punën e vet konform vendimet të kuvendit dhe kjo e bënë këtë rregullore të paligjshme dhe si e tillë nëse aprovohet ai do ta apeloj në MAPL.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-ripërserit se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet, dhe kjo pikë të fuzionohet me pikën 4 të rendit të ditës, duke formuar një komision të përbashkët për hartimin e një rregullore për kuvendin dhe komitetet.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –paraqiti një rekapitullim të zgjeruar në emër të kryesuesit të komisionit për hartimin e rregullores së punës së kuvendit, duke cekur nevojën për hartimin e një rregullore të re, pasi vlerësoi se ka ndryshim të rrethanave dhe legjislacionit prej kohës kur është hartuar rregullorja e vjetër. Më tej ai sqaroi bazën juridike, të mbështetjes së këtij dokumenti, modelin që është marrë dhe ceku se kjo rregullore mëton të lehtësoj punën e kuvendit dhe organeve të tij dhe ka për qëllim të racionalizoj mënyrën e debati dhe kohën në diskutim ku për këtë njoftoj se është marr si model Rregullorja e Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Tutje ai në mënyrë të detajuar i sqaroi edhe ndryshimet që janë bërë në tekstin e këtij drafti, renditja e neneve dhe paragrafëve në tekst dhe forma e hartimit. Kjo draft-rregullore ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit publike dhe si e tillë e ka plotësuar të gjitha kushte për ta marr aprovimin e kuvendit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se kryesuesja e kuvendit ka për obligim të ruaj gjuhën në kuvendin e komunës, dhe mos të lejoj që të denigrohen vlerat e personalitetit të anëtarëve të kuvendit nga askush. Kjo nuk duhet lejuar dhe nuk duhet nxitur siç edhe po ndodhe me disa anëtar të kuvendit që fuqia e tyre politike është minore. Tërhiqi vërejtjen se kjo do të jetë hera e fundit që toleron një gjuhë të tillë në kuvend, pas që kryesuesja e kuvendit nuk është duke e kryer punën e saj si duhet.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-sqaroi se Ligji për Vetëqeverisje Lokale nuk përmban dispozitat që rregullojnë çështjen e shkarkimit të kryesuesit të kuvendit, por ligji hedh parimet e përgjithshme të rregullimit të çështjeve dhe marrëdhënieve të caktuara juridike, në rastin konkret ligji përcakton se me rregullore të kuvendit mund të parashikohen rregulla specifike për miratimin ndryshimin dhe plotësimin e pikave të rendit të ditës e në rastin konkret mund parashihen edhe dispozita tjera për shkarkimin e kryesuesit të kuvendit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-diskutoj lidhur me nenin 24 të kësaj rregulloreje, ku përcaktohet lidhur me dërgimin e ftesës dhe materialeve të kuvendit e që thuhet: Materialet e mbledhjes së kuvendit, anëtarëve të kuvendit iu dërgohen 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit në formë elektronike, të shtohet se materialet duhet të dërgohen edhe në formë fizike.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-propozoi që materialet e kuvendit dhe komitetit të dërgohen edhe në kopje fizike deri në pajisjen e anëtarëve të kuvendit me lap-top ose me tablet që shërbejnë për funksionin e njëjtë (shtjellim i materialeve të kuvendit-pikat e rendit të ditës). Ndërsa pika e 5 e nenit 22 duhet të fshihet.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikët të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 7 vota “kundër” aprovoj Rregulloren për Punën e Kuvendit.

4. Rishqyrtimi i Rregullores për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit;

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-propozoi që rregullorja për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të shfuqizohet.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se nënkryetari i komunës nuk ka të drejt të propozoi para kuvendit për aktet e që miratohen, dhe rishqyrtimi i kësaj rregulloreje ka të bëjë me nenin 4 pika 4 që e ka gjetur MAPL që nuk është konform dispozitave të legjislacionit në fuqi. Andaj komisioni hartues i ka dhënë përgjigjet e tij para MAPL-së, dhe është i mendimit se ky nene duhet të harmonizohet duke u riformuluar konform ligjit në fuqi.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se propozimi i tij ishte të shfuqizohet kjo rregullore pasi që e njëjta nuk është e nevojshme, sepse rregullorja e kuvendit që u aprovua më herët përmban depozitat që flasin për themelimin e komiteteve dhe komisioneve të kuvendit. Mandej shtoi se kjo rregullore është vlerësuar jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe si e tillë duhet të hedhet poshtë, sepse e njëjta nuk hyrë fare në fuqi, ky është propozimi i tij si nënkryetar i komunës që është legjitim dhe mbete në vullnetin e kuvendit se a do votoj apo jo.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se edhe atëherë kur kishte dhënë idenë për themelimin e komiteteve tjera kishte vu në vëmendje, se nuk është kusht të nxjerrët kjo rregullore për të pasur mundësi të thelohen komitetet tjera, sepse Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimet Administrative e parashohin një gjë të tillë. Andaj kjo rregullore duhet të harmonizohet dhe aprovohet dhe më pas të procedohet me themelimin e këtyre komiteteve. Rregullorja duhet të aprovohet për faktin se i konkretizon edhe më tej kompetencat e këtyre komiteteve. Tek neni 14

propozoi të shtohet paragrafi kompensimi i anëtarëve të komisioneve dhe komiteteve bëhet sipas ligjit në fuqi.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –sqaroi se me rregulloren e kuvendit është përcaktuar se Kuvendi i Komunës mund të themeloj komitete dhe komisione varësisht prej nevojave që i ka. Andaj rregullorja për komitetet është e panevojshme dhe si e tillë duhet të shfuqizohet.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikët të rendit të ditës kuvendi pas votimit, 11 “për”, 13 vota “kundër” dhe 2 votat “abstenim” nuk aprovohet rekomandimi i MAPL-së, për heqjen apo harmonizim e pika 4 të 4 të rregullores për komitete, si e tillë kjo rregullore mbetet pa fuqi ligjore, nga sa u tha u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim rishqyrtohet Rregullorja (KKV) Nr.04/2023 për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë e miratuar me datën 31.05.2023.

2. Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë duke ju përgjigjur kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e aktit të cekur më lartë vendosi që pika e 4 e nenit 4 të mos hiqet nga rregullorja për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me arsyetimin se puna e komiteteve dhe komisioneve është rregulluar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryesuesja e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe Sekretaria e Kuvendit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Arsyetim

Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 27 korrik 2023, ka rishqyrtuar Rregulloren (KKV) Nr.04/2023 për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë e miratuar me datën 31.05.2023 sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit të komunës të datën 03.07.2023 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në ç’ rast kuvendit pas votimit me 11 vota “për”, 13 vota “kundër” dhe 2 vota “abstenim” vendosi që pika e 4 e nenit 4 të rregullores që është objekt rishqyrtim të mos hiqet nga rregullorja, me arsyetimin se puna e komiteteve dhe komisioneve është rregulluar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Në rastin konkret konsiderohet se rregulloja nuk prodhon ndonjë efekt juridik, pasi e njëjta nuk ka hyrë në fuqi.

5. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-në emër komisionit për hartimin e kësaj rregulloreje njoftoi se rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, janë inkorporuar në rregullore, ndërsa shtoj se në faqen e fundit të këtij dokumenti, duhet të hiqet tabela dhe të vendosen gjobat sipas ligjit. Në faqen 5 nenin 8 të përmirësohet në vend të fjalës tarifa të vendoset fjala taksa.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti një sugjerim tek neni 13 faqe 9 të jetë i njëjte siç ka qenë me rregulloren e vjetër kjo për tu bërë lehtësira bizneseve dhe për të mundësuar zhvillimin ekonomik.

Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë së Inspektiveve-kërkoj të hiqet nga rregullorja gjobat për mbeturina që figuron tek neni 29, sepse udhëzimi administrativ 14/2015 i cili është shfuqizuar por që më vonë kjo çështje është rregulluar me Ligjin mbi Mbeturinat. Mandej tek faqja 32 kërkoj dhe propozoi për lokalet afariste që janë deri në 50m² të shënohet 50.1m².

Në fund të debatit lidhur me këtë pikët të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se duke analizuar këtë raport të shpenzimeve del në pah përfundimi se kemi të bëjmë me një performancë të tmerrshme të dështimit të realizimit të investimeve kapitale por edhe kategorive tjera buxhetore, me fjalë tjera dështimi në investime kapitale është i frikshëm dhe skandaloz në vitin 2023. Dështim ka pasur edhe vitin e kaluar për periudhën e njëjtë, por atëherë arsyetimi ka qenë se kishte pasur vonesa në aprovimin e buxhetit të komunës, e që për vitin 2023 nuk mund të ketë kësi lloj arsyesimesh sepse buxhetit është aprovuar me kohë në mënyrë unanime, por asgjë nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë sa i përket realizimit të buxhetit. Për këtë shifra jashtëzakonisht shqetësues, pyeti kryetarin e komunës se ku qëndron problemi a ka sabotazhë nga drejtoret komunal, apo përgjegjësit apo bëhet fjalë për paaftësinë e kryetarit të komunës, sepse realizimi i buxhetit është i barabartë me komunat e veriut të vendit të cila për një kohë kanë funksionuar pa kryetar komunash.

Edona Gashi, anëtare e kuvendit-tha se ky raport e tregon në mënyrën më të mirë të mundshëm gjendjen katastrofike të performancës së komunës për këtë periudhë, sepse përqindja e shpenzimit të buxhetit në investime kapitale nuk e ka merri as 1% dhe kjo është për keqardhje. Pa hyrë në detaj tek Drejtoria e Urbanizmit buxheti për kapitale për afro 3 milion euro sa ka kanë qenë të planifikuar, janë shpenzuar vetëm 30.000.00 € që i bie vetëm 1 %. Pastaj në aspektin profesional raporti ka shumë gabime, tabelat janë proceduar me vonesë sepse tabelat analitike nuk përputhen me shumat sipas kategorive buxhetore, gjithashtu ceku se në raport mungon tabela e subvencioneve që është dashur të jetë pjesë e këtij raporti.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se bazuar në raport del se kemi përqindje të ulët të shpenzimit të buxhetit, edhe përkundër faktit se buxheti është aprovuar me kohë, por pengesa në realizim ka shkaktuar edhe vonesa në lejimin e bartjes së të hyrave vetnake që ka ndodhur për disa komuna të shkaktuar nga Qeveria e Kosovës. Ky është njëri ndër faktorët që ka ndikuar në përqindjen e ulët të realizimit të buxhetit në investime kapitale. Kohëve të fundit shihet një lëvizje pozitive sa i përket kontraktimit të projekteve përmes prokurimit publik, ndonëse gjendja nuk është e kënaqshme, andej inkurajon qeverinë komunale të përdor të gjithë mekanizmat dhe resurset humane të komunës për të përshpejtuar në realizimin e buxheti dhe zhvillimin e projekteve kapitale në interes të përgjithshëm qytetar. Në fund kërkoi të kemi një mobilizim të përgjithshëm për shpenzuar dhe realizuar buxhetit, për ndryshe kemi një alarm të ndezur se gjendje do të jetë edhe më keq se sa në vitin e kaluar dhe suficitit do jetë i tmerrshëm me çka do të dëmtohet interesi qytetar dhe dëmtimit ekonomik i komunës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se bazuar në tablat e raportit që në janë dërguar njëra bashkangjitur me raport e tjera e dërguar më vonë shihet se ka mospërputhje mes vlerave financiare në realizim p.sh për ndërtimin e një depo kemi vlera financiare njëra 4000 € kurse tjetra 7000 €, për këtë kërkoj nga kryetari i komunës që të kërkon përgjegjësi tek personat përgjegjës sepse kemi të bëjmë me para publikë dhe nuk duhet lejuar lëshim të tilla kur bëhet fjalë për dokumente zyrtare.

Pastaj shtoj dhe vlerësoi se duhet të kemi përgjegjësi dhe kërkoj mobilizim nga qeveria komunale për të intensifikuar përpjekjet për realizimin e buxhetit sepse realizimi është në fazë kritike deri në momentet kur po flasim.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës-njoftoi kuvendi sa janë kontraktuar projekte në vlerë prej 4 milion euro dhe tani ka filluar intensifikimi i realizimit të projekteve në teren në investime kapitale, shkollat dhe renovimi i tyre do të bëhet me kohë, sepse viteve të kaluara ka pasur gjithë vonesa në fillimin e mësimin për shkak të mos renovimit të shkollave me kohë. Lëndët djegës për shkollat janë siguruar, tani pritet fillimi i realizimit të projekteve në kanalizime. Ka problem për sa i përket kontraktimit të projekteve për shkak të procedurave dhe ankesave në OSHP. Vitin e kaluar por edhe këtë vit ka pasur probleme sa i përket të hyrave të bartura, por megjithatë komuna jonë ka dal në mesataren e komunave tjera për sa i përket realizimit të investimeve kapitale. Mandej u zotua se do të ketë kontroll të rreptë të mbikëqyrjes së projekteve nga menaxheret e kontratave dhe nuk do të lejohet shkaktimi i dëmeve në buxhet por edhe në kualitetin e projekteve, për këtë është iniciuar edhe kontraktimi i një kompanie për mbikëqyrjen e projekteve. Në fund njoftoi se nuk ka neglizhencë nuk ka sabotazhë por është një ekip i mirë që po mundohet të gjej mënyrën më të mirë për realizimin e këtyre projekteve.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikët të rendit të ditës kuvendi pas votimit, 12 “për”, 15 vota “kundër” nuk aprovohet Raporti gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor Financiar, Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se auditori i përgjithshëm ka monitoruar si mostra pak lëndë-kontrata pesë sosh, dhe në këto pak lëndë ka gjetur një mori shkeljesh gjatë vitit 2022, ku janë identifikuar zbatim të pagesave pa u kryere punët që konsiderohen si shkelje të rënda, pra bëhet fjalë për rregullimin e shtratit të Lumit “Silnica”, kontrata e ndërtimit të parqeve, kontrata e furnizimit me klima, kontrata e renovimit të palestrës. Pra kanë ndodhur pagesa punët nuk janë kryer dhe kjo e gjetur nënkupton shkelje e rënd e Ligjit të Prokurimit Publik. Kërkoj që këto kontrata dhe pagesat për punët e pa kryera ti ofrohen kuvendit për t’i shikuar dhe për t’i analizuar. Tek përzgjedhja e operatorëve është bërë përzgjedhja e një operatorit ekonomik të papërgjegjshëm, ku flitet për një gurëthyes i cili nuk ka licencë në fundin e obligimeve kontraktuale gjegjësisht në zbatimin kontratës, pra komuna realizon projekte me operator ekonomik të papërgjegjshëm dhe pa licencë kjo është lajm. E gjetur tjetër është se komuna paguan fatura në vlerë prej 45,850 € për QKMF, QPS për periudhën janar-gushtë dhe nëntor-dhjetor 2022 në shpërpushje me marrëveshjen, që e ka lidhë komuna me Ndërmarrjen “Përparimi” edhe këto fatura i kërkoj të ketë qasje. Kërkoj të sillet raporti i ndërmarrjes “Përparimi” dhe lista e të punësuarave në këtë ndërmarrje. Po ashtu edhe tek subvencionimi në bujqësi tek bletët dhe një subvencionim i mbarështimit është bërë në shpërputhje me thirrjen publike dhe me rregulloren dhe kjo paraqet një tjetër shkelje ligjore. Mangësi në vlerësimin e aplikacioneve të subvencioneve tek motokultivatorërt, të cilët kanë qenë 2 përfitues të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me thirrjen për aplikim. Dihet fakti se thirrja për palët në momentin e shpalljes është ligj dhe përfituesit që nuk plotësojnë këto kritere është shkelje nëse janë përfitues. Të gjitha këto të gjetura janë vetëm disa nga shkeljet e konstatuara nga auditori i përgjithshëm e për të cilat do të kërkojnë llogari.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-tha se raporti i auditorit të përgjithshëm edhe pse është i pamodifikuar për pasqyrat financiare për vitin 2022 është i mirë, por nuk duhet të jemi të kënaqur për faktin se nga 21 rekomandimet e auditorit që kanë qenë nga viti i kaluar vetëm 5 janë zbatuar plotësisht, 11 pjesërisht dhe 5 janë të pazbatuara. Edhe rekomandimet e auditorit për vitin e ardhshëm janë gjithsejtë 21, 5 janë të reja, 15 të përsëritura dhe 1 pjesërisht i përsëritur. Mbase auditorit me dhënien e opinionit e ka pasur parasysh se është viti i parë qeverisës, por me një mal të gjeturash që i ka cekur në raport, ndërsa në vitin e ardhshëm nuk beson që do të jetë një opinion i njëjtë. Nëse i referohemi faqes 4 të raportit ku ceket baza për konkluzion ku thuhet se në pesë projekt janë identifikuar mangësi gjatë ekzaminimit fizik të tyre, përzgjedhja e operatorit ekonomik të papërgjegjshëm vlere e kontratës 147,000.00 €, mungesa e projekteve ekzekutuese për procedurat e prokurimit, faturimet jo në pajtueshmëri me marrëveshjet, mangësi në regjistrimet kontabël të pasurive, thirrjet publike në bujqësi, mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, pastaj vonesa në pagesat e faturave në vlerë 93,000.00 € e shumë të tjera të ngjashme.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se raporti i auditorit të përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës së Vushtrrisë për vitin 2022 mbanë titullin i pamodifikuar, që me fjalë jo ekonomike i bie se në Komunën e Vushtrrisë nuk ka pasur keqpërdorime dhe kqeklasifikime të parasë publike si dhe nuk ka mos pajtime të pasqyrave financiare të komunës të mbajtura dhe të raportuara. Kjo është pozitive sepse raporti viteve të kaluar ka qenë jo i mirë dhe kjo e privon komunën nga disa beneficioneve siç është ai i përfitimit të disa granteve. Me fjalë tjera ky raport e nxjerr Komunën e Vushtrrisë mirë sa i përket menaxhimit të financave publike dhe nuk ka keqpërdorime. Pastaj shtoi se rekomandimet që kryesisht të përsëritura nga vitet e kaluara me disa përjashtime, duhet të adresohen me urgjencë dhe të njëjta me përgjegjësi e kompetencë duhet zbatuar. Ai shtoi se në adresimin e këtyre rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm nuk duhet kursyer askënd edhe ata të cilët nuk i kanë ndërmarr veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre duke përfshirë stafin e komunës së Vushtrrisë. Në përgjithësi auditor në raport jep një opinion të drejt dhe të saktë për pasqyrat financiare të komunës, andaj kërkoi nga kryetari i komunës që ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe vërejtjeve.

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës janar – qershor 2023;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pyeti drejtoreshën e kulturës se përse nuk është zbatuar vendimi i muajit maj për ekzekutimin e shpërblimeve me rastin e ndarjes së çmimeve të nderit për nder të ditës së çlirimit të Vushtrrisë, ekzekutimi në mjete monetare. Kërkoj që ky vendim të zbatohet sa më parë.

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;

10. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022/2023;

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se kjo informatë është e stërmëbushur me detaje të pa rëndësishme e që janë të pa nevojshme. Por nëse lëshohem në gjëra konkrete për shembull testi i maturës dhe ai i arritshmërisë shihet se në gjimnaz kalueshmëria është 93%, por në shkollën profesionale është 37% respektivisht 36% në shkollën teknike, ndërsa kur e mbledhim përqindje e këtyre tri shkollave përqindja del 55.6% e që i bie se nuk kanë kaluar afër 45.5% e nxënësve

maturantë. Nëse i referohemi arritshmërisë del diçka që është shqetësuese gjimnazi e ka pasur arritshmërinë 55% që është bilanc i varfër, shkolla profesionale i ka rreth 40 % e po ashtu edhe shkolla teknike rreth 40%. Sa i përket suksesit shkëlqyeshëm në shkollat e mesme kanë kaluar rreth 20%, ndërsa në testin e maturës kemi vetëm një nxënës të shkëlqyeshëm sepse vetëm një nxënës ka marr më tepër se 90 pikë, ndërsa numri i nxënësve që ka marr mbi 80 pikë është dy dhe kjo paraqet shqetësim për suksesin tejet të dobët. Problemi i shqetësimi qëndron në faktin se kemi disproporcion mes suksesit që vlerësohet nga profesorët në fund vit dhe ai në testin e maturës që është një test pa më mirë i kontrolluar.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se drejtori i arsimit ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë dhe e përgëzoi ndërsa shtoj se parafolësi i tij ka bërë një lëshim në kalkulimin e mesatares së kalueshmërisë së nxënësve në tri shkollat e mesme. Më tej ceku se në nivel individual kemi shumë sukses ku ceku se një nxënës nga fshati Stanoc i Epëm është renditur i pari në nivel të Republikës së Kosovës ai është Adriana Haxhaj i cili meriton një shpërblim nga ana e komunës. Duke ju referuar numrit të nxënësve ceku se Komuna jonë ka gjithsejtë 11,335.00 nxënës të ndarë në 651 paralele, që i bie se numri mestarë për klasë është 17.41 nxënës për paralele e që është numër i ngarkuar. Në disa shkolla kemi numër të madh të nxënësve nëpër shkolla dhe duhet krijuar kushtet për rritjen e hapësirës shkollore. Është për tu përshëndetur veprimi i kryetarit të komunës për rritjen e vlerës së burës prej 400 në 600 € për studentë. Ndërsa shtoj se është e pa tolerueshme që është anashkaluar Universiteti "Hasan Prishtina" nga përfitimi i bursave për studentët e tij, por edhe përjashtimi i drejtimeve të informatikës dhe shkencave tjera ekzaktet që janë drejtime deficitare, por nuk mund të konsiderohen drejtime deficitare shkencat e mjekësisë. Në fund propozoi të ri shpallet një konkurs për bursa ku do të futen drejtimet deficitare si ajo i informatikës në Universitetin "Isa Boletini".

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të kësaj informate del se gjatë kësaj periudhe është ndërprerë kontrata për furnizim me kifile për nxënësit e nivelit para fillor deri tek klasat e pesta, dhe mendon se kjo është një gabim nga ana e DKA-së. Gjatë kësaj periudhe po ashtu kemi pasur përsëritje të konkurseve e rrjedhimisht edhe humbje të orëve. Në informatë konstatohet se kemi numër të madh të mungesave të nxënësve. Po ashtu kishte me qenë mirë që si DKA të bëni përpjekje maksimale për rritjen e mësimin praktik në kuadër të shkollave teknike dhe profesionale duke e lidhur mësimin teorik me mësimin praktik dhe me mësimdhënien në vendin e punës. Pastaj kemi një shpërputhje mes suksesit të nxënësve nga klasa e parë deri në pestën ku suksezi është i mirë dhe më pas nga klasa e pestë deri në të nëntën suksezi vjen duke rënë, kurse rënia më madhe e suksesit është në klasët X-XII. Në informatë janë cekur disa donacione simbolike p.sh donacion prej 100 € gjë e cila nuk paraqet ndonjë rëndësi për tu cekur. Ajo çka është shqetësuese është fakti i rënie së madhe të numrit të nxënësve. Si anëtar i komisionit ka hasur në disa parregullsi ndër të tjera ceku: kemi shkollë që fare nuk ka bërë protokollimin e dëftesave, dëftesa të plotësuar me dy ngjyra të lapës-kimikëve një ngjyrë notat dhe një ngjyrë tjetër numrin e pikëve, dëftesa të pavulosura, dëftesa me gabime teknike të nënshkruar edhe nga kujdestarët e klasëve edhe nga drejtorët e shkollave, dëftesa me numër të pikëve të arritshmëris të vendosur aty ku e kanë vendin por jo të mbledhura deri në fund e që jep mundësi për manipulim dhe dëftesa në cilat nxënësi e ka të shënuar emrin por nuk e ka të shënuar mbiemrin. DKA duhet të iu tërheqë vërejtjen drejtorëve të shkollave që mos të lejojnë kesi lloj lëshimesh në të ardhmen. Në fund ceku se është lajm i mirë që nxënësja e gjimnazit Adriana Esat-Haxhaj ka zënë vendin e parë në testimin për pranimin në Fakultetin e Mjekësisë, e po ashtu lajm i mirë është edhe nxënësja Almedina Haradinaj e cila është renditur në këtë listë e pesa më radhë, që të dyja këtë studente tashmë jetojnë në Stanoc dhe me

punën e tyre na kanë bërë krenar. Për këto nxënës propozoi që tu ndahet ndonjë mirënjohje dhe bursë apo shpërblim monetar për sukseset e arritura.

Dardan Abazi, drejtor i DKA-së- paraqiti sqarime lidhur me informatën për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022/2023, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se na gëzon fakti për sukseset individuale dhe kolektive për nxënësit tanë sidomos për ata nxënës që kanë arritur suksese të larta në pranim në Fakultetin e Mjekësisë. Pastaj shtoi se është mirë që po bëhet sistemimi i të dhënave për nxënësit dhe krijimi i një data-baze unike për sistemin e arsimit në Vushtrri. Mandej ceku se është mirë të merren edhe statistikatat e shkollës së mjekësisë në Mitrovicë, sepse kemi nxënës nga Komuna e Vushtrrisë që i ndjekin mësimet në atë shkollë, dhe i rekomandoj drejtorit të DKA-së që të përdor e-shkollarin si instrument për lehtësimin e punëve me ndjekjen e procesit mësimor, sidomos tek çështja e pranimit të nxënësve në shkolla. Në fund ai i përgëzoi të gjithë nxënësit që kanë arritur suksese kulminante dhe kërkoi nga DKA në Vushtrri që ata nxënës të mbështeten me bursa dhe shpërblime në mjete monetare.

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive në Komunën e Vushtrrisë;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pyeti Drejtoreshën e Kulturës se përse nuk është marrë për bazë rekomandimi i anëtares së KPF-së i cili është votuar për tu inkorporuar në rregullore kriteret për përzgjedhjen e sportistit të vitit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 18 vota “për” aprovoj Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve Sportive në Komunën e Vushtrrisë.

12. Shqyrtimi i kërkesës së Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës – ish-objekti i QKMF-së për nevojat e Spitalit në Vushtrri;

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-sqaroi se e kanë analizuar këtë pikë të rendit të ditës, dhe del se secila pronë e cila jepet në shfrytëzim, ligjërisht duhet të jetë në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim, dhe e njëjta pronë nuk është e evidentuar në këtë listë. Mandej njoftoi se pas takimit që ka pasur kryetari i komunës me ministrin e Shëndetësisë, ky i fundit është zotuar se do ta shtrij ndikimin e tij që disa prona që janë shpallur zonë me interes për komunën të kthen në shfrytëzim Komunës së Vushtrrisë për realizimin e projekteve me interes të përgjithshëm. Po ashtu kërkesë e kryetarit të komunës ka qenë që vendi parcelat-kodrat e Banjskës të barten në pronësi komunale për qëllime zhvillimore të komunës sonë, dhe jemi në pritje që këto prona ti kthehen komunës ashtu që të kemi njëfarë këmbim mes ministrisë dhe komunës të këtyre pronave. Andaj kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet deri në një vendim pozitiv nga ana e ministrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-deklaroi se si grup kuvendar e mbështesin këtë pikë të rendit të ditës gjegjësisht kërkesën SHSKUK-ës për bartjen e kësaj prone. Kjo për faktin se ministria ka arsytuar çështjen e investimeve në Spitalin e Vushtrrisë, dhe zgjerimi i hapësirës është i domosdoshëm me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore të nivelit sekondar. Nëse shkohet me këmbimin e ndonjë prone mes komunës dhe ministrisë sa i përket kësaj prone dhe ndonjë prone tjetër, kjo do të ishte e mirëseardhur, por meqë komuna nuk ka hartuar

ndonjë planë-projekt lidhur me këtë pronë atëherë kjo pronë duhet të bartet tek ministria me qëllim të hapjes së rrugës për investime. Kërkoj që kjo pikë të procedohet për votim dhe aprovim, sepse në të kundërtën rrezikohet të humbet donacioni.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se kërkesa lidhur me këtë pronë duhet të jetë më specifike, sepse është kërkuar parcela, ndërsa aty gjende edhe objekti. Pastaj në kërkesë është kërkuar parcela P-02358-7, kurse në këtë listë nuk figuron por është tjetër numër i parcelës me që është paraqitur Nr.0358-12, andaj këtu nuk është prezantuar parcela të cilën e ka kërkuar Ministria e Shëndetësisë d.m.th këtu është bërë ndonjë gabim teknik.

Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-s qaroi se duhet të bëhet identifikimi i parcelës në pjesën grafike dhe tekstuale.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-kërkoj me mirëkuptim që kjo pikë të shtyhet për muajin shtator deri sa të merret ndonjë vendim nga ministria e linjës që ti kthehen në pronësi komunës pronat që janë me interes të përgjithshëm.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit i'a dha fjalën për sqarime zyrtarit të komunës z.Haki Maloku, por anëtari i kuvendit z.Ilmi Azemi, protestoj duke deklaruar se zyrtari në fjalë nuk ka të drejt të marr fjalën në kuvend dhe të diskutoj, duke e penguar diskutimin e tij tek foltorja e kuvend, në rastin konkret kryesuesja e kuvendit duke marr masat e nevojshme konform rregullores e ndërpreu mbledhjen në ora:17:04, dhe njoftoj se mbledhja e ndërprerë do të vazhdohet nesër.

Më datën 28 korrik 2023 ditë e premte ora 16:10 kryesuesja e kuvendit hapi punimet e mbledhjes së ndërprerë të datës 27 korrik 2023, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 23 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme me pika e rendit të ditës në renditje numërore pikat 12, 13,14,15,16 dhe 17 të mbetura nga mbledhja e ndërprerë.

Prezent në mbledhje janë: Agron Përçuku, Alban Bajrami, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Galip Audiu, Gresa Muli, , Refik Maloku, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Ali Januzi, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Gentiana Rama, Leonora Gërguri, Nasuf Aliu dhe Shkelzen Xhaferi.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-lidhur me pikën 12 të rendit të ditës njoftoi se ka pasur një takim me ministrin Vitija ku është kërkuar nga ky i fundit që ish-objekti i QKMF-së të kaloj në pronësi të spitale gjegjësisht në kuadër të SSHKUK-së, për nevoja të investimeve infrastrukturore për zgjerimin e hapësirave shëndetësore. Tutje ceku se Komuna e Vushtrrisë ka jashtëzakonisht shumë nevoja për prona për zhvillimin e projekteve investive kapitale me interes të përgjithshëm, dhe ndonjë këmbim të pronave me Ministrinë e në rastin konkret me Ministrinë e Shëndetësisë do të ishte tepër e mirëseardhur. Pastaj njoftoj se kërkesë e tij si kryetar i komunës ka qenë që kodrat e Banjëskes të barten në pronësi komunale me qëllim të zhvillimit të një zone industriale. Kërkesë tjetër e tij ka qenë që pronat e AKP-së, ka kërkuar që ti kthehen komunës pasi që komuna është e gatshme të paguaj pjesën prej 20%. Ai ka marr premtime nga ministri se do të ketë investime në

zgjerrimin e shërbimit të urgjencës dhe në parkingun nëntokësor, dhe qasje e tij është në favor të kësaj ideje që koj peronë ti kalohet në shfrytëzim ministrisë gjegjësisht SSHKUK-së, por me dy kushte që të ndodhin investime dhe nënë dy që prona-objekti të shfrytëzohet për qëllime shëndetësore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se është për çdo lavdatë pozicionimi i kryetarit të komunës për zhvillimin e politikave në interes të përgjithshëm, por shtoj meqenëse nuk janë të sigurt investimet, për faktin se nuk ka afat të implementimit të këtyre investimeve, dhe për këtë propozoi që kjo pronë të jetë në shfrytëzim afatshkurtër me afat prej 3 viteve me mundësi vazhdimi që nëse ndodhur investimi të mundësohet bartja e pronës, ashtu që komuna të bëj ruajtjen e pronës së vetë, të mos shkohet në infinitin e rrezikut sepse ka mundësi ndryshimi me ndërrimin e politikave shëndetësore qeveritare. Për organizata e qeverisë nuk ka nevojë të zhvillohet asnjë procedurë sepse është dhënie e veçantë e pronës komunale.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-përsëriti se si grup kuvendar i LVV-së e mbështesin kërkesën e SHSKUK-së, për bartjen e kësaj prone e procedura përmes Ministrisë së Shëndetësisë, kjo për faktin se të gjithë jemi në dijeni për mungesën e hapësirave që i ka Spitali i Vushtrrisë, andaj në rastin konkret është një mundësi e mirë që të zgjerohet rrjeti dhe infrastruktura për ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore sepse ato shërbime në instancë të fundit i marrin qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Në këtë rrjedh ai kërkoi nga kuvendi që të procedoj me aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës për faktin se duhet të jepet mundësia për zhvillimin e këtyre investimeve dhe këtij projekti. Nga bisedat që ai ka pasur me përfaqësuesit e ministrisë, ka marr zotimin e tyre se projekti është gati dhe investimet janë të sigurt se do të realizohen. Në rastin më të keq nëse investimi nuk ndodh, ministri është zotuar se vetë ministria do realizoj këtë projekt.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-konstattoj se edhe pse të gjithë janë pro kësaj pike që të votohet, por duhet bërë të ditur që objekti i cili po jepet në shfrytëzim nuk ndodhet as në listën e përgjithshme e as në atë të veçantë për dhënien e pronave në shfrytëzim. Prandaj gjasat janë shumë të mëdha që ministria ta kthej këtë çështje si të kundërligjshme. Propozimi i saj ishte që kjo çështje të dërgohet në Drejtorinë e Gjeodezisë që kjo pronë të futet në listën e pronave e më pas të silllet në kuvend për aprovim.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se nëse ky propozim-vendim është në kundërshtim me ligjin atëherë është mirë të shtyhet dhe të dërgohet në drejtorinë kompetent e më pas të silllet për votim e jo në këtë formë të silllet në lajthitje kuvendi i komunës.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit- sqaroi se fillimisht kjo pronë duhet të futet në listën e pronave për dhënien në shfrytëzim, mandej të procedohet me marrjen e vendimit, por forma si po tentohet nuk është e rregullt.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se është mirë që merret një opinion nga MAPL, se kemi të drejt të japim pronë në shfrytëzim në rastet e veçanta, kur prona nuk gjendet në listën për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe më pas në muajin shtator të votohet kjo pikë e rendit të ditës.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim dy propozime fillimisht u votua propozim me shkrim i cili ishte proceduar nga ekzekutivi komunale, i cili pas votimit mori 6 vota “për” ndërsa propozimi i anëtarit të kuvendit z.Ilmi Azemi, pas votimit mori 13 vota “për”, 7 vota “kundër” dhe 2 vota “abstenim” dhe kësioj aprovohet propozimi i fundit.

Nga ky rezultat i votimit u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në shfrytëzim afatshkurtër për tri (3) vite, me mundësi vazhdimi, pas realizimit të investimeve, parcela kadastrale P-70202016-02358-7, në sipërfaqe prej 7380m², ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë e evidentuar në emër të P.Sh. Shtëpi e Shëndetit, ashtu që përgjatë kësaj periudhe të realizohet investimi nga ana e Shërbimi Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që lidhet me financimin e projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë.

2. Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin, Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për nevoja të zgjerimit e hapësirave infrastrukturore të Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri.

3. Për pronën e cila jepet në shfrytëzim, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës obligohet që të financoj projektin për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë.

4. Në rast të ndërrimit eventual të lokacionit/zhvendosjes së spitalit në një lokacion tjetër gjatë periudhës kohore për të cilën i jepet në shfrytëzim, prona e paluajtshme e komunës e cila i jepet në shfrytëzim i rikthehet Komunës së Vushtrrisë në shfrytëzim.

5. Autorizohet Kryetari i Komunës që pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi të lidhë kontratë me përfaqësuesin MSH/SHSKUK për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

13. Shqyrtimi dhe aprovimi Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për themelimin e KKSB-së;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 20 vota "për" 1 votë "kundër" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si vijon :

1.1 Në paragrafin 1, pika 1.10, z.Zharko Mitroviç, Prift i Kishës ortodokse serbe, caktohet anëtar i KKSB-së

1.2 Në paragrafin 1, pika 1.14, z.Adem Hoti, Përfaqësues i komunitetit ashkali, caktohet anëtar i KKSB-së.

1.3 Në paragrafin 1, pika 1.15, z.Aziz Emini, Përfaqësues i Komunitetit rom, caktohet anëtar i KKSB-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
14. Shqyrtimi Informatës gjashtë mujore lidhur me punën e KKSB-së;
15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për verifikimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së në Vushtri dhe objektet tjera shëndetësore;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se për këtë çështje është bërë shumë debat dhe zhurmë dhe janë dhënë shumë opinione pro dhe kontra, por e vërteta është se kur filet për standardet e ndërtimit, ai prezantoi disa fakte dhe prova me fotografi të përshkruar për gjendje se si ai e kishte gjetur në kohën kur e kishte marrë pozitën e drejtorit të shëndetësisë në Vushtri sidomos gjendjen në QMF në Druar dhe Smrekonicë dhe Lumadh, ku ndërtimi ishte bërë në kohën e kryetarit Mulaku dhe të PDK-së dhe meremetimi dhe ndërtimi i këtyre qendrave ishte bërë jashtë çdo standardi dhe në kundërshtim të plotë me ligjin. Lidhur me këtë çështje ai ceku se nuk lejohet dhe kurrë nuk do të tentonte të ndërton kauza politike mbi bazën e shpifjeve, por është i detyruar ta ngadhënjë të vërtetën mbi shpifjen, në këtë relacion shtoi se si grup kuvendar janë të gatshëm dhe të hapur të verifikojnë çdo gjë duke formuar këtë komision dhe duke dalë e vërteta në shesh.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se ka shumë objektet infrastrukturore të shëndetësisë që nuk janë rinovuar dhe ndërtuar sipas standardeve dhe për të gjitha janë të gatshëm të bëhet ndonjë hetim i veçantë që të shikohet se kush ka bërë shkelje dhe të vihet para përgjegjësisë. Në këtë kontekst shtoi se ka fakte dhe dëshmi se pikërisht në kohën kur z.Mehulli ka qenë drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë është ndërtuar objekti i ri i QKMF-së dhe po atëherë ka pasur shkelje të para masës dhe parallogaisë në këtë projekt kapital. Ndër të tjera ai lexoi një statusi në rrjetin social në facebook ku z.Mehulli me krenari prezantoi punët në objektin e ri të QKMF-së, e pikërisht në këtë kohë kanë ndodhur shkeljet që tani janë publikuar në këtë objekt ku gjendje në ndërtim është e mjerueshme.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-sqaroi se punimet në objektin e ri të QKMF-së, kanë vazhduar edhe për dy vit tjera pasi ai e ka lënë pozitën e drejtorit të DSHPS, dhe pranimit teknik i këtij objekti është bërë saktësisht tri vite e gjysmë pasi ai e ka lënë këtë pozitë, andaj nëse vërtet ka pasur shkelje në këtë projekt atëherë pse është bërë pranimit i këtij objekti nga kjo qeverisje aktuale pasi janë konstatuar shkeljet.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-përsëriti se është mirë të formohet ky komision dhe të gjendet e vërteta për të gjitha këto dilema, më tej shtoi se pikërisht në kohën kur z.Mehulli ka qenë drejtor i DSHP-së, janë vendosur disa kalda në objektet shëndetësore që nuk janë me fuqi të funksionit sipas paramasës dhe parallogarisë dhe për këtë ai duhet të japë përgjegjësi.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit konstatoi se sllë janë vetëm 16 anëtarë të kuvendit, dhe rrjedhimisht bazuar në legjislacionin në fuqi nuk kemi kuorum për marrjen e vendimeve të plotfuqishme dhe kështu mbledhja u ndërpre në ora:17:04, ndërsa për vazhdimin e mbledhjes njoftoi se do të informoheni me kohë me shkrim.

Më datën 30 nëntor 2023 ditë e enjte ora 10:10 kryesuesja e kuvendit hapi punimet e mbledhjes së ndërprerë të datës 27-28 korrik 2023, konstatoi se në sallë janë të pranishëm 21 anëtarë të

kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme me pika e rendit të ditës në renditje numërore pikat 15,16 dhe 17 të mbetura nga mbledhja e ndërprerë, e datës 28 korrik 2023.

15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për verifikimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së në Vushtrri dhe objektet tjera shëndetësore;

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para kuvendi tha se është për keqardhje ndërprerja dhe shtyrja e kësaj mbledhje nga muaji korrik, dhe kërkoj me ngulëm që të formohet ky komision ashtu që të zbardhet e vërteta e të gjitha shkeljeve që kanë ndodhur në ndërtimin e objektit të ri të QKMF-së, por edhe në objektet tjera. Në saje të kësaj pike të rendit të ditës ai kërkoj që kjo çështje të adresohet në organet kompetentet të hetuesisë dhe prokurorisë, dhe pikërisht për këtë ai kërkoj që propozimi i tij të hedhet në votim për aprovimin e një rekomandimi-kërkese për prokurorinë e shtetit që të merret me hetimin e kësaj çështje.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se pasi që ka pretendime se kanë ndodhur shkelej sa i përket standardeve të ndërtimit, atëherë është mirë të ngritet ky komision që konstatohet gjendja faktike lidhur me këtë objekt dhe objekte tjera.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se si grup kuvendar i LDK-së, e përkrahin propozimin që të formohet ky komision për konstatimin e gjendje faktike në objektin e ri të QKMF-së dhe objektet tjera shëndetësore. Ai vlerësoi se nga fillim kjo çështje është politizuar dhe kurrë nuk ka pasur gatishmëri që kjo çështje të zbardhet deri në fund dhe në mënyrë të drejt dhe të saktë. Si zyrtar të LDK-së ceku se janë të qenë sepse asnjëherë nuk kanë qenë të implikuar në këtë çështje dhe në këto shkelej të supozuar, andaj le të formohet komisioni dhe le të zbardhet e vërteta për këtë çështje.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 24 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni kuvendar për konstatimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së dhe objekteve tjera shëndetësore në përbërjen si në vijim:

1.1. Mentor Hasni, anëtar i kuvendit- PDK;

1.2. Bujar Pllana, anëtar i kuvendit- LDK;

1.3. Gresa Muli, anëtare e kuvendit-LVV.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendim obligohet të bëjë konstatimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së dhe objekteve tjera shëndetësore, dhe pas përfundimit të këtij procesi obligohet të hartoj raport me shkrim të cili ia ofron Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për aprovim.

3. Për zbatimin e këtij vendim obligohet: komisioni kuvendar për konstatimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së dhe objekteve tjera shëndetësore.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 13 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoj edhe këtë:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **30 nëntor 2023**, duke marrë për bazë propozimin e anëtarit të kuvendit z.Faton Hyseni, nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, pasi ka shqyrtuar gjendjen faktike në objektin e ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, i cili është ndërtuar gjatë viteve 2019-2020, e që dyshohet se ka pasur keqpërdorime lidhur me këtë projekt-kapital për sa i përket standardeve të ndërtimit dhe shkelje tjera në lidhjen e kontratave të dëmshme dhe në kundërshtim me ligjin si rezultat i kësaj, pas një analize të hollësishme parashtron këtë:

Rekomandim-Kërkesë:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri që të zhvilloj hetime, lidhur me keqpërdorimet eventuale gjatë kohës së ndërtimit të objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, i cili është ndërtuar gjatë viteve 2019-2020, e që ka indikacione sa ka pasur keqpërdorime lidhur me këtë projekt-kapital për sa i përket standardeve të ndërtimit dhe shkelje tjera në lidhjen e kontratave të dëmshme dhe në kundërshtim me ligjin.

16. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarjen e çmimit “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” për z.Rilind Musa;

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se ky sportit vërtet e meriton këtë çmim dhe është mirë që të shikohet mundësia që të konsultohet Drejtorja e Financave që vlera e këtij çmimi të rritet.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-njoftoi se grupi kuvendar i PDK-së e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë çështje dhe ka shprehur lëvdatat dhe mirënjohjet më të larta për sportistin z.Rilind Musa, dhe konsideron se kjo çështje duhet të procedohet në DKRS, për ofrimin e ndihmës për këtë sportistë.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se grupi kuvendar i PDK-së nuk ka pasur dhe nuk tregon konsistencë për këtë çështje, sepse ky propozim është bërë që nga muaji korrik 2023 dhe prej atëherë drejtoresha e DKRS nuk ka pasur kurajë dhe vullnet për tu marr me këtë çështje, andaj propozoj që hedhet në votim dhe të aprovohet ky propozim-vendim.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se vullneti i të gjithëve është që këtij sportisti ti ndihmohet pasi që i njëjti ka treguar rezultate të mira në veprimtarinë e tij dhe konsideron se i njëjti e meriton këtë çmim që ti ndahet nga ana e kuvendit. Ai vlerësoi se do të ishte mirë që ky propozim të shqyrtohet dhe analizohet në Drejtorinë e Kulturës, që të evitohen të gjitha paqartësitë dhe dilemat ashtu që të votojmë një çështje drejt dhe sakti dhe mos të kthehet ky vendim më vonë si i kundërligjshëm nga ana e MAPL-së, kjo për faktin se ky propozim-vendim nuk i ka kaluar të gjithë hapat ligjor sepse i njëjti nuk ka kaluar në komisionin kompetent për vlerësimin e dekoratave, andaj konsideron se për tu sqaruar kjo çështje duhet të kthehet edhe njëherë në DKRS, për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se për këtë çështje janë shterur të gjitha debatet dhe kjo çështje tashmë është konsumuar dhe trajtuar, andaj nuk ka kurrfarë arsye që sot të mos votohet, propozoj që e njëjta me vota unanime të aprovohet, mandej konsideron se kjo çështje ky sportist nuk duhet të politizohet por duhet me votë ti jepet vendi i merituar këtij sportisti.


Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se është për keqardhje që kjo çështje po shtyhet deri në pafundësi, për një sportistë që e meriton ti ndahet ky çmim, andaj ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit që votojnë për aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 16 vota “për” 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z.Rilind Musa, i ndahet çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrisë” për të arriturat e tij në sportin e Bodybuilding.
2. Dorëzimi i këtij çmimi bëhet në mënyrë solemne nga Kryetari i Komunës së Vushtrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Mbledhja përfundoi në ora: 10:55.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit